

SFIDA E LAICIZMIT NË SHKOLLË, NËPËRMJET INTERPRETIMIT TË LETËRSISË

Ermira ALIJA

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

ermira_alia@yahoo.com

821.18:37

Abstract

Starting by considering the communism breakdown brought an official opinion stating that our literature, as many other national literatures, is a cultural part that cannot be understood without the religious background; this article considers on bringing out the opinion that when it is being talked about the religious projection over literature and culture, laicism remains a challenge. The managing ways toward this challenge, our study finds it related strongly to wider educational politics that are connected deeply by the idea of studying religion basics in everyday educational program.

This article states that the study and the communication over the philosophical, cultural and anthropologic elements, over the sacred nature concepts, over the religious symbols structure and their historical meaning not only helps explaining literature easier as a literary concept related to philosophy or religion but also in a self-multidimensional projection toward human consciousness overpassing personality self-restriction in the name of ideology.

The ideas that bring out flexibility and tolerance are evaluated as an indirect contributes among the present discussions over communicating religion as an education in the school programs. They also bring attention toward scientific, social and other discipline study expansion over religion, philosophy, anthropology, etc., and their participation as a working or discussing object at school.

Key words: *Religion, literature, symbol, meaning, projection.*

Përmbledhje

Përmbysja e komunizmit solli pranimin zyrtar të opinionit se letërsia jonë, ashtu si edhe letërsia e shumë vendeve të tjera, është pjesë e kulturës që nuk mund të kuptohet dhe interpretohet pa ndikimet fetare. Artikulli shtron çështjen, se në kushtet kur flitet për ndikimin e fesë në letërsi dhe kulturë, laicizmi mbetet sfidë. Mënyrën e menaxhimit të kësaj sfide,

studimi e sheh të lidhur me problemet e politikave arsimore e më gjerë, sidomos sot, kur flitet për futjen e njohurive fetare në shkollë.

Ai tregon se studimi dhe komunikimi mbi elemente të dimensionit filozofik, kulturor e antropologjik të fesë, mbi konceptet e natyrës të së shenjtës, mbi strukturën e simboleve fetare dhe domethëniet e tyre historike ndihmon jo vetëm në shpjegimin më të mirë të letërsisë si ndriçim i literaritetit (letrarësisë) në raport me filozofinë a religjionin, por edhe në vetëprojektimin më shumë se njëdimensional të vetëdijes së njeriut dhe si rrjedhojë në tejkalimin e vetëkufizimit të personalitetit të tij në emër të ideologjisë.

Ide të tilla që ushqejnë elasticitet dhe tolerancë, shihen si kontribut, megjithëse jo i drejtpërdrejtë, në tërësinë e diskutimeve që po bëhen sot mbi mënyrën e dhënies së fesë, apo edukatës fetare në shkollë. Ato tërheqin njëkohësisht vëmendjen për zgjerimin e studimeve shkencore, sociale apo ndërdisiplinore mbi fenë, filozofinë, antropologjinë etj., dhe përfshirjen e tyre si objekt pune e diskutimi në shkollë.

Fjalët kyçe: *Fe, letërsi, simbol, domethënie, vetëprojektim.*

Me ndryshimet e kohëve tona dhe të problematikave që ajo ka nxjerrë, ka një tendencë të hapet kurrikula e letërsisë, si art e si kulturë. Hapja e saj si e tillë përkon me ballafaqimin nga shkolla edhe të disa problemeve, si: raporti me njohjen jo vetëm si dije, por edhe si qenie, raportin me identitetin dhe atributet qytetërore, me krizën e njëdimensionalitetit të dijes e të vetëperceptimit etj. Nga ana tjetër flitet për *Kanonin*⁷⁶ si quint-esencë estetike, që karakterizohet nga: autenticiteti, universaliteti, pakohësia (si aftësi për t'i kapërcyer të gjitha epokat), mbi konceptin e kanonizimit (mungesës, përmbysjes apo rindërtimit) në letërsinë shqipe.

Letërsia shqipe është formuar si letërsi kombëtare nëpërmjet dy faktorëve: personazheve e vendeve shqiptare (si etnokulturë, si etnitet kulturor) dhe gjuhës shqipe. Çështja e letërsisë shqipe si letërsi kombëtare (ashtu si edhe e letërsive të tjera) mbetet e hapur: si marrje në raport me ndryshimet, kulturat e si dhënie ekzotike, historie. Letërsia shqipe (me shqipen dhe etnokulturën e vet) fillon me shkrimin e teksteve liturgjike që synonin të ndihmonin ushtrimin e fesë. Por, bëhet fjalë, në studime të ndryshme, edhe për dokumente që përfaqësojnë gjurmë të lëvizjes heretike dhe që mendojnë se shqipen e shkruar në Shqipërinë e mesme e të jugut e përdorën për herë të parë heretikët, për nevoja të predikimit kundër kishës bizantine, gjuhën

⁷⁶Shehri, Dh., *Statusi i kritikës*, Albas, 2013, f 27

greke të së cilës nuk e kuptonte populli, por edhe kundër kishës bullgare, gjuhën sllave të së cilës gjithashtu nuk e kuptonte populli. Këtu fillon raporti i të shkruarit shqip me rrethanat e tij historiko-kulturore, ndoshta potencialisht si kanon i hapur.

Shkrimet e mëtejshme biblike të Buzukut, Matrëngës, Budit, Bardhit e Bogdanit formojnë bërthamën e letërsisë së vjetër shqiptare. Pas këtyre shkrimeve ka kontekste historike dhe kulturore të ndryshme, që lidhen në fillim me konkurrencën për ndikim të Romës me Patriarkanën e Kostandinopojës, (ndikim që në trevat shqiptare, nuk ishte homogjen as në kohë dhe as në hapësirë) dhe pastaj me lëvizjet e reformës dhe të kundër reformës. Kështu që shkrimet biblike u ndikuan nga:

- traditat e ritit katolik, por që përdornin domosdo si gjuhë riti greqishten (qarku i arbëreshëve të Italisë)

- traditat e ritit katolik, mbetur nën ndikimin e Romës (qarku i katolikëve të Veriut të Shqipërisë)

- traditat e ritit ortodoks (qarku ortodoks i Jugut).

Shkrimet e të tre qarqeve kanë të përbashkët: raportin e gjuhës amtare me gjuhën e Zotit, si nevojë riti dhe shpirti. Raporti i secilit prej qarqeve me këtë qasje është i veçantë, ka karakteristikat e veta në hapësirë, kohë dhe tipologji. Historia e rrugëtimit të Letërsisë biblike nuk është historia e Biblës në Letërsi, por është historia e Biblës së letrarizuar. Kërkimi i letërsisë në të mund të identifikohet me kërkimin e letrarësisë, si: “ngasje” e shkrimtarit, si ndjesi e shprehshmërisë të shqipes, si potencial polisemantik, abstragues, a sugjestiv, si stil, etj.

Në pikëpamje sinkronike, letrarësinë e veprave filobiblike mund ta hetojmë vetëm duke studiuar veçantinë që sjellin këto shkrime si përzgjedhje, si shmangie, plotësim a interpretim ndaj origjinalit, si përdorim gjuhe, si konotacion i ndryshueshëm në kohë dhe hapësirë. Pra ne s’mund të argumentojmë letrarësinë, jashtë njohjes biblike, antropologjike, gjuhësore⁷⁷, etj. Kjo “letërsi fetare” shpreh një marrëdhënie të së shenjtës me shkrimin, që interpretohet në kontekstin religjioz e kulturor të cilit i përket.

⁷⁷ Kemi parasysh disa argumente, ndër të cilat mund të përmendim: përdorimin e h-së në shkrimet e para të shqipes nga Buzuku, si një dukuri fonetike jo funksionale, në: Beci Bahri, *Rreth së ashtuqajturës “h” irracionale në veprën e Gjon Buzukut*, botuar në: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Buzuku dhe gjuha e tij*, Tiranë 2005

Nga ana tjetër, konsolidimi ose jo i kësaj marrëdhënieje gjuhësore bëhet vrasës ose ushqyes për letrarësinë.⁷⁸ Njohja dhe krahasimi i arketypeve tekstore të të njëjtit rrafsh ligjërimi (biblik) sjell krahasimin e letrarësisë mes autorëve. Kurse pasurimi i teksteve të letërsisë me detaje që janë rezultante të studimeve të ndryshme ndërdisiplinare, (gjuhësore e antropologjike në periudha të ndryshme teologjike: politeiste e monoteiste⁷⁹, plotëson më mirë vetëprojektimin më shumë se njëdimensional të njeriut.

Organizimi në vargje, pavarësisht se si bibël e poetizuar, sjell organizim tjetër gjuhësor. Ballafaqimi i tekstit të poezisë si funksion i mirëfilltë me tekstin që shënon tejkalimin e alegorisë biblike, sjell tek nxënësi konceptin e potencës së gjuhës dhe të raportit të së shenjtës me të, si një raport jo njëvalent, si kapërcim i një qarku të mbyllur simbolik, si rivendosje e një raporti të ri të qenies njerëzore. Rivendosja e raporteve është një tregues i laicizmit në shkollë, por jo i ateizmit, që do të thotë se merrja parasysh e konvencave origjinale pa “frikën” nga “dogma fesë” është e rëndësishme, ashtu si dalja nga këto konvenca, masa që nganjëherë janë delikate dhe të ndjeshme.

Diskutimi i kodit biblik si një kod i hapur gjuhësor, frymon elementë transhendentale njerëzore dhe lidh vetëdijen me nënvetëdijen, temën fetare me laike (por jo ateiste, në kuptimin e përplasjes së hyjnore me natyroren) dhe stimulon mospërdorimet standard të koncepteve. Tek ky raport i hapur mund të gjenden edhe përmasa të komunikimit kulturor si në rastin e trajtimit të së njëjtës temë biblike, nën ndikime të ndryshme kulturore⁸⁰ (të barokut religjioz a iluminizmit).

Pikëpamja e Bogdanit se natyra është një ligjërimit nëpërmjet të cilit Zoti i drejtohet njeriut, dhe koncepti i tij i shkrimit si ngasje fton për ta parë fenë si filozofi dhe si raport filozofish, të paktën i atyre që ai citon: Kalvinit, Luterit e dijetarit pers Avicenës (Ibn Sina), të fton edhe në diskutimin e raportit të fesë me diturinë, si dhe në një komunikim ndërfaqet.

Tejkodimet e brendshme që mbartin leksemat, si: ylli, dielli, drita, hana, qielli, dheu, qiri, janë potencë për ta menduar të shenjtën si kozmogoni që lidhet me dijen e amshuar, që çon jo thjesht te metafizika si thelb e si gjuhë, por edhe tek metafizika si mistikë e si rrjedhojë në tejkalimin e vetëkufizimit të personalitetit të njeriut në emër të ideologjisë.

⁷⁸ Sinani, Sh., “*Kënga e këngëve*” në katër shekuj përkthim: *Buzuku, Kuteli, Filipaj*, argumenton se si nga shkalla e lirisë së përkthimit vjen e zmadhohet (te Kuteli), ose zvogëlohet (te Filipaj) (brenda së njëjtës pjesë biblike).

⁷⁹ Sinani, Sh., *Gjurmë të ligjërimit ungjillor të krishtërimit të hershëm në biblën shqip*, QSA, Instituti filozofik dhe teologjik, Lezhë 2010, *Bibla shqip dhe Filipaj* (studime), fq 46

⁸⁰ Neziri, Z., *Pjetër Budi dhe Jul Variboba*, revista “Malësia”, nr 6.

Kurse raporti i tyre me letërsinë sjell të menduarit e Kanonit si universalitet (kr: kozmogonia e Bogdanit, Naimit, Poradecit). Shekulli XVII, kur bashkekzistoi shkrimi i konfesionit fetar të krishterë dhe shkrimi me alfabet oriental, sjell çështjen e rezistencës së kulturës vendore dhe të përparimit jo vijor të saj. Dukja e disa zhanreve, si epi fetar romantik, mevludi, poezia lirike mistike, ilahia etj., trajtimi i temës laike dhe përzierja me atë fetare në këtë letërsi, poemat *Hadikaja* e Dalip Frashërit (Kopshti, epopesë së parë në gjuhën shqipe, shkruar më 1842 ngjante 65000 vargje, vepër që flet për Qerbelanë), apo “Myhtarnameja”, e Shahin Frashërit (i vëllai i Dalip Frashërit, më 1868, me 13000 vargje po për Qerbelanë) ftojnë në diskutime për konceptet e qytetërimit islam, identitetit qytetërimor, të atributit lindor, perëndimor dhe të Modernizimit, Perëndimizimit etj., provokojnë të folurin për dinamika të brendshme e transformime konjitive, si dhe për studime jothjeshtësuese.

Edhe poezia e Nezim Frakullës, bëhet provokim për pranëvënien: lirizëm filozofik a misticizëm, por edhe për çështjen e frymëzimit si transhendencë dhe gjuhë. Mundësia që kanë për t’i folur njeriut dhe letërsisë, mitet, figurat, simbolet fetare varen nga studimi dhe marrëdhënia me to, gjë që sjell relativizimin e të vërtetave, si rrjedhojë edhe vetëprojektimin më shumë se njëdimensional të vetëdijes së njeriut dhe tejkalimin e vetëkufizimit të personalitetit të tij në emër të ideologjisë.

Sot, kur flitet për futjen e njohurive fetare në shkollë, ide të tilla duhet të shihen si kontribut, megjithëse jo i drejtpërdrejtë, në këtë lëmi. Studime të tilla, të ndërthurura me ato sociale, filozofike, antropologjike etj., duke u përfshirë si objekt pune e diskutimi në shkollë, kontribuojnë në pikëpamje letrare në qartësimin e formimit të shtratis të asaj që ne e quajmë letërsi kombëtare, kurse në pikëpamje njerëzore zbusim desakralizimin e dijes të cilën nuk e ka bërë vetëm komunizmi, por nganjëherë edhe “shkencizmi” si absolutizim i legjitimitetit të vet dhe si reduktim i të sipërmes tek e poshtmjia.

Bibliografi

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Buzuku dhe gjuha e tij*, Tiranë 2005

Chittick, C. W., *Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit, Përshtatësia e kozmologjisë islame në botën moderne*. Botimet “ENEAS”, “Zemra e Traditës”, Tiranë, 2011.

Sinani, Sh., *Tradita gojore*,

Shehri, Dh., *Statusi i kritikës*, Albas, 2013

“Malësia”, nr 6, ISSN 1800-5764; “Malësia” (Podgoricë), COBISS:CG-ID 3641357